



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 25.05.2023, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KLUBIT TË HENDBOLLIT
“PRISHTINA” - MESHKUJT

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të hendbollit “Prishtina” - meshkujt.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve nga Drejtoria e Sportit.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, klubit të hendbollit “Prishtina” - meshkujt, të cilat Komuna e Prishtinës i ndan si mbështetje financiare për mbarëvajtjen e garave në Super Ligën e Kosovës në Hendboll, për kategoritë: Senior, Junior, Kadet, Pionier, pjesëmarrje në kupat evropiane në shtator 2023, ku zhvillohet ndeshja e pare me ekipin austriak, si dhe organizimi i turneut në mes të 16 shkollave të komunës së Prishtinës.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Sportit dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-107155/23, më 29.05.2023

